



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr: 01/125
Datë: 16.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 (paragrafi 4) dhe 93 (paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në Nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe Nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75 % të Ndërmarrjes Publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. PTK. për shpalljen e Konzorciumit ACP Axos Capital GmbH - Najafi Companies LLC si ofertuesi me i favorshëm ekonomik.
2. Komisioni Qeveritar për Privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së të vazhdojë për procedim të mëtutjeshëm në procesin e privatizimit dhe shitjen e aksioneve sipas procedurave të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit për privatizimin e 75 % të aksioneve të PTK-së dhe legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Zëvendëskryeministrave;
- të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Anëtarëve të Komisionit Qeveritar për Privatizimin;
- Arkivit të Qeverisë.